



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSISË

Tiranë, më 16. 7. 2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

MBI

PROJEKTLIGJIN,

“PËR ASISTENCËN SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. Hyrje

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 3, 5, dhe 15.07.2019, mori në shqyrtim projektligjin, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, nismë e Këshillit të Ministrave.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator znj. Ardiana Jaku.

Në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar, mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm Znj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, objektivat, efektet e synuar të propozimit dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit:

Ky projektakt ka për qëllim të rregullojë mënyrën e dhënies së ndihmës ekonomike, pagesave të aftësisë së kufizuar dhe bonusit të bebeve, për të garantuar mbrojtje sociale për të gjithë qytetarët.

Projektligji garanton mbështetje për familjet dhe individët në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike.

Projektligji garanton administrim, kontroll më të mirë mbi përdorimin e fondeve të asistencës sociale, shmangien e abuzivitetit dhe menaxhim më të mirë të informacionit nëpërmjet Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit.

Objektivat dhe efektet e synuara të propozimit:

i. Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me programin e ndihmës ekonomike, kanë të bëjnë me:

- administrimin dhe funksionimin e një skeme të përmirësuar të ndihmës ekonomike;
- thjeshtimin e procedurave të panevojshme për shkak të riorganizimit të skemës, të cilat janë bërë pengesë për mospërfitimin në kohë të ndihmës ekonomike;
- nxitjen e punësimit dhe përfshirjen e personave në moshë aktive pune përfitues të ndihmës ekonomike në programet aktive të punësimit dhe formimit profesional;
- mosrefuzimin e ofertave të përshtatshme të punës nga zyrat e punës;
- forcimin e masave shtrënguese në rastet e refuzimit apo largimit nga puna, me synimin për të shmangur sigurimin e të ardhurave në mënyrë alternative (informale);
- përjashtimin nga detyrimi i paraqitjes në zyrat e punës për tu regjistruar si punëkërkues të papunë të anëtarëve të familjeve në zonat rurale që zotërojnë ose jo tokë bujqësore në pronësi/përdorim, apo familjeve që kanë anëtarë në moshë aktive pune, që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, por jo më shumë se deri në moshën 25 vjeç;
- menaxhim dhe kontroll më të mirë mbi përdorimin e fondeve të ndihmës ekonomike dhe shmangien e abuzivitetit.

ii. Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me programin e aftësisë së kufizuar, kanë të bëjnë me:

- përcaktimin e të drejtës së përfitimit të pagesave të personave me aftësi të kufizuar dhe të të drejtës së përfitimit të një ndihmësi personal;
- trajtimin e barabartë të të gjitha grupeve të aftësisë së kufizuar; (iii) thjeshtimin e procedurave të panevojshme për përfitimin e pagesave të aftësisë së kufizuar (heqjen e vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak), dhe dhënien e këtij përfitimi bazuar në vendimin e autoritetit përgjegjës për përcaktimin e kësaj të drejte (komisionit të vlerësimit).

iii. Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me bonusin e bebeve (ndihma e menjëherëshme financiare për foshnjat e porsalindura), kanë të bëjnë me:

- krijimin e një politike të re sociale pro lindshmërisë;

- ofrimin e një ndihme të drejtpërdrejtë për të përkrahur lindjen e fëmijës;
- dhënien e bonuseve të shumëfishuara për fëmijët e lindur.

Ky projektakt mundëson përcaktimin e kategorive përfituese të ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe bonuseve të bebeve.

Thjeshtohen procedurat e panevojshme për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar procese të qarta dhe efiente të aktorëve të përfshirë në administrimin e skemës. Aneksohet roli i Këshillit Bashkiak i cili në të shumtën e rasteve për shkak të mosmbledhjes në kohë pengonte dhënien e përfitimeve në kohë, duke penalizuar qytetarët.

Ky projektakt shmang abuzivitetin në skemën e ndihmës ekonomike duke nxitur qytetarët të përfshihen në programe formimi profesional për të marrë një profesion, përfshirjen në programe këshillimi për punësim, si edhe punësimin e tyre përmes ofertave të punës që disponojnë zyrat e punës. Gjithashtu i hap rrugën krijimit të një strategjie daljeje nga skema e ndihmës ekonomike të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune përfitues të ndihmës ekonomike, duke siguruar riintegrimin social të tyre.

Projektakti përcakton mënyrën e financimit të programeve së asistencës sociale, kontrollin e përdorimit të fondeve, sanksionet në raste të konstatimit të shkeljeve dhe procedurën e ankimimit për qytetarët duke ezauruar të gjitha shkallët e ankimimit.

Anashkalohet vendimmarrja e Këshillit Bashkiak për dhënien e ndihmës ekonomike që jepet përmes sistemit të pikëzimit, pasi kjo e drejtë i është atribuar me ligj Drejtorisë Rajonale të SHSSH, dhe deri më tani vendimmarrja e Këshillit Bashkiak kufizohej vetëm në propozimin e familjeve aplikuese, ndërkohë që vendimi me familjet përfituese nga sistemi i pikëzimit nuk përfshin të gjitha familjet aplikuese. Shpesh herë Këshilli Bashkiak ka penguar shpërndarjen në kohë të ndihmës ekonomike jo vetëm për përfituesit nën juridiksionin e kësaj bashkie por për të gjithë qarkun.

Po ashtu, anashkalohet vendimmarrja e Këshillit Bashkiak për pagesat e aftësisë së kufizuar, për shkak se kjo e drejtë i jepet individit në bazë të vlerësimit të komisionit të posaçëm për vlerësimin e aftësisë së kufizuar.

Skema aktuale e aftësisë së kufizuar është një skemë e cila do të vazhdojë të aplikohet në të gjithë vendin deri në momentin e shtrirjes së reformës së aftësisë së kufizuar, e cila do të realizohet në mënyrë progresive deri në vitin 2019 në qarkun Tiranë, deri në vitin 2020 në qarqet Elbasan dhe Durrës dhe deri në vitin 2024 në nëntë qarqet e tjera të vendit.

Përmbajtja e projektligjit:

Projektligji, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, propozon konkretisht sa më poshtë:

1. Në Kreun I të tij, në nenet 1-5 përcakton objektin, qëllimin, fushën e zbatimit, parimet dhe perkufizimet e termave të përdorur në përmbajtje të projektligjit;

2. Në Kreun II parashikohen programet asistencës sociale përkatësisht:

- Në nenin 6, subjektet përfituese të programeve të asistencës sociale të ndara sipas programeve,
- Në nenin 7 përfshihen kategoritë përfituese të ndihmës ekonomike,
- Në nenin 8 grupet përfituese të pagesës së aftësisë së kufizuar,
- Në nenin 9 subjektet përfituese të bonusit të bebeve
- Në nenin 10 subjektet përfituese të ndihmës personal.

- Në nenin 11 të projektaktit parashikohen edhe kategoritë të cilat nuk përfitojnë nga ky ligj.

3. Në Kreun III parashikohen llojet e përfitimit nga programet e asistencës sociale, ku përkatësisht:

- Në nenin 12 të ligjit përcaktohen përfitimet e ndihmës ekonomike, si një pagesë në masë të plotë duke hequr edhe tavanin e ndihmës ekonomike për familje e cila aktualisht është 8.000 lekë. Ndihma ekonomike do të përfitohet nga familjet pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera. Kufizimi kohor do të synojë integrimin në jetën shoqërore të familjeve në skemën e ndihmës nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit, me qëllim që kjo skemë të mos përdoret si mekanizëm përfitimi që mund të çojë në papunësi të zgjatur të antarëve të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike dhe për ta kthyer këtë në një skemë aktive.
- Në nenin 13 përcaktohet e drejta e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar e cila garantohet si një e drejtë që në rastet e punësimit të personit me aftësi të kufizuar, përfitohet deri në 4 vite krahas pagës,
- Në nenin 14 pagesa që jepet për ndihmën e menjëherëshme financiare për foshnjat e porsalindura. Përcaktimi i procedurës dhe masave të përfitimit i atribuohet Këshillit të Ministrave.

4. Në Kreun IV parashikohen kriteret dhe procedurat e përfitimit nga programet e asistencës sociale përkatësisht:

- Në nenin 15 përcaktohen rastet që përjashtohen nga skema e ndihmës ekonomike dhe afatet e përjashtimit nga e drejta për aplikim dhe përfitim.
- Në nenin 16 parashikohet procedura e aplikimit për ndihmë ekonomike e cila realizohet nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar, pranë administratorit shoqëror, nga subjektet përfituese të ligjit. Parashikohet që formula e unifikuar e pikëzimit të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave në vartësi të nivelit të varfërisë në vend. Ky nen përcakton që të drejtën e tërheqjes së ndihmës ekonomike në familje e ka gruaja. Ky përcaktim bëhet me qëllim që ndihma ekonomike të përdoret për mbulimin e nevojave të familjes dhe fëmijëve dhe të mos përdoret për qëllime të tjera. Dhënia e ndihmës ekonomike gruas do të bëjë të mundur shmangien e abuzimit në përdorimin e kësaj ndihme që i jepet familjes.
- Në nenin 17 parashikohet procedura e përfitimit të përfitimeve të aftësisë së kufizuar dhe dhënia e këtyre përfitimeve në bazë të vendimit të komisionit të vlerësimit, duke shmangur vendimin e Këshillit Bashkiak. Gjithashtu, në këtë nen parashikohen edhe rastet e ndërprerjes së pagesës së aftësisë së kufizuar.
- Në nenin 18 të tij i jep të drejtën kategorive përfituese të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar që të përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

5. Në Kreun V përcaktohen dispozita lidhur me drejtimin dhe administrimin e programeve të asistencës sociale, ku përkatësisht:

- Në nenin 19 roli dhe përgjegjësitë e Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale
- Në nenin 20 rolet dhe përgjegjësitë e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror e rajonal.
- Në nenin 21 përcaktohet roli i Këshillit Bashkiak i cili fokusohet vetëm në

përcaktimin e kriterëve dhe vendimmarrjen për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike.

- Në nenet 22 dhe 23 të projektaktit parashikohen roli, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të vetëqeverisjes vendore për administrimin e skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

6. Në Kreun VI:

- Në nenin 24 parashikohet financimi i programeve të asistencës sociale i cili realizohet nga Buxheti i Shtetit.
- Në nenet 25 dhe 26 parashikohet programimi dhe transferimi i fondeve të asistencës sociale
- Në nenin 27 kontrolli i përdorimit të fondeve nga organet e specializuara të kontrollit, krahas kontrollit të përcaktuar në nenin 20 të projektaktit.

7. Në kreun VII:

- Në nenet 28 dhe 29 parashikohen sanksionet dhe procedura e ankimimit
- Në nenin 30 parashikohet procedura e re e vlerësimit bazuar në modelin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, e cila do të detajohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo skemë do të shtrihet në mënyrë progresive, fillimisht në qarkun Tiranë, më pas në Qarqet Elbasan dhe Durrës dhe deri në vitin 2024 në të gjithë vendin
- Në nenin 31 përcaktohet dispozita kalimtare për përdorimin e regjistrit elektronik kombëtar të të dhënave për aplikuesit dhe përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku po zbatohet modeli i vlerësimit bio-psiko-socil të aftësisë së kufizuar. Ky nen parashikon dispozitën kalimtare për zbatimin e reformës së aftësisë së kufizuar.
- Në nenin 32 identifikohen aktet nënligjore që dalin në zbatim të projektaktit.
- Në nenin 33 përcaktohet shfuqizimi i ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar dhe lënia në fuqi e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9355/2005 që nuk bien në kundërshtim me projektaktin e propozuar, deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij projektakti.
- Në nenin 34 parashikohet hyrja në fuqi e projektaktit.

IV. Efekti Financiar

Efekti financiar i projektligjit është fondi i pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Pagesat shtesë për vaksinimin dhe ndjekjen e arsimit të detyrueshëm për fëmijët e familjeve përfituese janë brenda tavaneve të këtij fondi sipas projektbuxhetit afatmesëm. Burimi i financimit është buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përkatësisht në zërin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” në Programin buxhetor “Përkujdesi Social”.

V. Konsultimi Publik

Projektligji është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Gjatë hartimit të projektligjit janë zhvilluar konsultime të hapura në mjediset e MSHMS në datë 09 Janar 2019, si dhe projektligji është shpallur për konsultim edhe në faqen elektronike zyrtare të saj.

Gjithashtu projektligji është konsultuar në 61 bashkitë e vendit dhe në Këshillin Konsultativ të Qeverisë Qendore dhe Vetëqeverisjes vendore.

VI. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij bëri një pasqyrim dhe analizë të detajuar të projektligjit. Ai u shpreh për problematikat lidhur me skemën aktuale të ndihmës ekonomike të cilat kanë të bëjnë me mosmbledhjen në kohë të këshillave bashkiakë të cilët kanë penalizuar vazhdimisht qytetarët në mosmarrjen në kohë të përfitimit të ndihmës ekonomike, i cili është i vetmi burim të ardhurash për këto familje në nevojë. Problematikë tjetër që evitohet në skemën aktuale ka të bëjë me shmangien nga punësimi të përfituesve të ndihmës ekonomike të cilët janë në moshë aktive pune dhe mospërfshirjen e tyre në programe formimi dhe aftësimi për punë.

Relatori theksoi se nëpërmjet këtij projektligji synohet përcaktimi i rolit dhe i përgjegjësiive të institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor në fushën dhënies së ndihmës sociale. Projektligji ka në themel të tij vendosjen e një skeme përfitimi që konsiston në tre elementë, të cilët janë:

- Individët, familjet në nevojë
- Personat me aftësi të kufizuar
- Nënata me foshnja të porsalindura

Anëtarët e tjerë të komisionit, theksuan rëndësinë e këtij projektligji në kuadër të përmirësimit të skemës së asistencës sociale.

Në përfundim Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, duke ritheksuar dhe vlerësuar se miratimi i këtij projektligji është i nevojshëm dhe sjell elementë të shumtë të shtuar, në kuadër të rolit social të shtetit duke mundësuar trajtim financiar më të plotë për disa kategori mjaft të veçanta.

VII. Përfundime dhe ndryshimet e projekt aktit (nen për nen)

Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, duke vlerësuar si tejet pozitive mundësinë që krijohet përmes këtij projektligji, për dhënien e asistencës sociale, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim nen për nen dhe në tërësi me ndryshimet e mëposhtme:

- Neni 1 i projektligjit, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale.”

- Neni 3 i projektligjit, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuar në Republikën e Shqipërisë dhe nënata me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale, me përjashtim të kufizimeve të vendosura në nenin 11, të këtij ligji”.

- Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

- në gërmën a) pas përcaktimit “universaliteti” të shtohen fjalët “është parimi që përcakton se”
- në gërmën b) pas përcaktimit “drejtësia sociale” të shtohen fjalët “është parimi që përcakton se”
- në gërmën c) pas përcaktimit “mbështetja sociale” të shtohen fjalët “është parimi që përcakton se” dhe përcaktimi “subjektet” zëvendësohet me përcaktimin “personat”
- në gërmën ç) pas fjalëve “integritetit të përfituesit” të shtohen fjalët “është parimi që përcakton” dhe përcaktimi “kujdesit shoqëror” të zëvendësohet me fjalët “asistencës sociale që”
- gërma d) riformulohet me këtë përmbajtje:

“d) Mosdiskriminimi është parimi që përcakton të drejtat që burojnë nga ky ligj pa asnjë lloj diskriminimi cdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të vecantë, ose për cdo shkak tjetër”

- në gërmën dh) pas përcaktimit “dhënave personale” të shtohen fjalët “është parimi që përcakton se”

- në gërmën e), përcaktimi “mosdiskriminimi” zëvendësohet me fjalët “është parimi që përcakton se”
- në gërmën ë) pas përcaktimit “partneriteti” të shtohen fjalët “është parimi që siguron”

- Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

- në gërmën “c” përcaktimi “subjektet” zëvendësohet me përcaktimin “personat”.
- në gërmën “ç”, pas përcaktimit “mjetet monetare” shtohet përcaktimi “asetet”.
- në gërmën “ë” para përcaktimit “Familjeve” të shtohet përcaktimi “individëve”.

- Gërma “h” riformulohet si vijon:

“h) “Kryefamiljar”, personi i parë sipas renditjes në çertifikatën familjare”.

- në gërmën “nj”, në fillim të fjalisë pas përcaktimit “Paraplegjik”, shtohet përcaktimi “Person”.

- në gërmën “r”, përcaktimi “ rekordeve” të zëvendësohet me përcaktimin “të dhënave”.

- në gërmën “rr”, përcaktimi “ rekordeve” të zëvendësohet me përcaktimin “të dhënave”.

- në gërmën “t”, në fillim të fjalisë pas përcaktimit “Tetraplegjik”, shtohet përcaktimi “Person”.

- pas shkronjës “z”, të shtohet shkronja “zh” me këtë përmbajtje

“zh) “Remitancë”, transfertat neto pa kundërshpërblim nga jashtë vendit”

- Neni 4 bëhet neni 5 dhe neni 5 bëhet neni 4.
- Në nenin 7 në titullin e tij të hiqet përcaktimi “Subjektet”
- Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:
 - në titullin e tij të hiqet përcaktimi “Subjektet”
 - në gërmën “a”, në fillim të fjalisë para përcaktimit “Paraplegjik”, shtohet përcaktimi “Personat”.
 - Në fund të gërmës b) shtohen fjalët: “si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.
- Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:
 - në titullin e tij të hiqet përcaktimi “Subjekti”
 - pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Masa dhe procedura e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të shërbimit spitalor dhe atyre të gjendjes civile përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

- pika 3 hiqet
- Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:
 - në titullin e tij të hiqet përcaktimi “Subjektet”
 - përcaktimi “pikat 1, 2 e 3” zëvendësohet me përcaktimin “gërmat a, b, dhe c”
- Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:
 - në titullin e tij përcaktimi “Subjektet” të zëvendësohet me “Personat”
 - në gërmën a) të hiqet përcaktimi “subjekteve përfituese” dhe zëvendësohet me përcaktimin “përfituesve sipas pikës 1”.
- Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:
 - në pikën 5, para përcaktimit “shtesë” të shtohet përcaktimi “pagesë”.
 - në fund të pikës 8 shtohen fjalët “dhe shkon deri në 150 përqind e masës së pensionit social dhe e indeksuar”
- Në nenin 13 të hiqet pika 2
- Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:
 - në gërmën ç), pika 2 të hiqet përcaktimi “shumë”

- Në nenin 17 bëhen këto ndryshime:
 - në titullin e tij fjalët “së aftësisë së kufizuar” zëvendësohet me fjalët “ nga personat me aftësi të kufizuar”
 - në pikën 1 përcaktimi “së aftësisë së” zëvendësohet me fjalët “nga personat me aftësi të”
 - në pikën 3 përcaktimi “së aftësisë së” zëvendësohet me fjalët “nga personat me aftësi të”
- Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:
 - në gërmën e) përcaktimi “pikën 1” zëvendësohet me përcaktimin “gërmën a”.
 - në gërmën ë) përcaktimi “pikën 1” zëvendësohet me përcaktimin “gërmën a”.
- Në nenin 27 fjalët “ligjet nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” të zëvendësohen me fjalët “legjislacionin në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.”
- Në nenin 28 bëhen këto ndryshime
 - në gërmën a) të pikës 1 fjalët “ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative” të zëvendësohen me fjalët “legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.”
 - Në gërmën b) pas përcaktimit “disiplinore” shtohen fjalët “sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil ose Kodit të Punës”
- Në pikën 4 të nenit 29 fjalët “përcaktimet e bëra në ligjin nr.49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar” të zëvendësohen me fjalët “legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”
- Në nenin 32 bëhen këto ndryshime:
 - në pikën 2 pas fjalëve “për çështjet sociale” të shtohen fjalët “ që brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ”
 - pika 3 të hiqet.
- Në nenin 33 pas përcaktimit “i ndryshuar” shtohen fjalët “si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me të.”

KRYETAR

RELATOR

Enver ROSHI

Ardiana JAKU